



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:049206
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05383409

C. nr. 593/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil me gjyqtarin Astrit Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli në çështjen juridike kontestimore të paditësit Rr.E nga komuna e Gllogocit të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij H.K, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gllogoc, me objekt kontesti: Kompensim në emër të diferencës së pagave të papaguara për shkak të suspendimit (fitimit të humbur) dhe në emër të diferencës së pagës së papaguar për shkak të uljes së gradës (fitimit të humbur) të precizuara me datën 22.01.2024, vlera e kontestit prej **19.168,54 €**, pas seancës së shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 30.01.2024 në të cilën ishte i pranishëm i autorizuari i paditëses e në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, me datën 14.02.2024 e mori ndërsa me datën 23.02.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditësit Rr.E nga Komuna e Gllogocit.
- II. DETYROHET** i padituri Komuna e Gllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gllogoc që paditësit Rr.E të ia paguaj kompenzimin në emër të fitimit të humbur-të diferencës së pagave nga mos pagesa e 50% të pagës dhe atë: për periudhën kohore prej datës 11.11.2017 deri me datën 30.04.2020 në shumën prej **9, 366.25 €** me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë me datën 27.04.2020 e gjer në pagesën definitive, në emër të kontributeve pensionale të papaguara shumën prej **1,126.12 €**, dhe në emër të tatimit në pagën e papaguar në shumën prej **384,04 €**, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditë nga pranimi i këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.
- III. DETYROHET** i padituri Komuna e Gllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gllogoc që paditësit Rr.E, për shkak të ndryshimit të kontratës të ia paguaj kompenzimin në emër të fitimit të humbur-të diferencës së pagës së papaguar për shkak të uljes së gradës dhe atë: për periudhën kohore prej datës 01.05.2020 deri me datën 30.09.2023 në shumën prej **5, 598.88 €** me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data 01.05.2020 e gjer në pagesën definitive, në emër të Kontributeve pensionale të pa paguara të ia paguaj në Trustin Pensional shumën prej **600.26 €**, dhe në emër të Tatimit në pagat e papaguara të ia paguaj në Administratën Tatimore të Kosovës shumën prej **102.55 €**, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditë nga pranimi i këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.
- IV. REFUZHET si e pa bazuar** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej shumës së gjykuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për kompenzim në emër të diferencës së pagave, kontributit pensional dhe tatimit në pagë nga mos pagesa e 50% të pagës për periudhën kohore të suspendimit prej 6 muaj nga data 11.04.2017 deri me datën 11.10.2017 në shumën e përgjithshme prej **1990,54 €**.
- V. OBLIGOHET** i padituri që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej **1798.00 €**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

VI. REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesës së paditësit për kompensim të shpenzimeve të procedurës kontestimore përtej shumës së aprovuar në pikën V të këtij dispozitivi.

A r s y e t i m

Pretendimet e Palëve

Paditësi përmes të autorizuarit ka parashtruar padi ndaj të paditurës për kompensimin e fitimit të humbur – të diferencës të pagave prej 50% të pagës për shkak të suspendimit dhe kompensimin e fitimit të humbur - të diferencës së pagës së papaguar për shkak të uljes së gradës, duke theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura rreth 26 vite, në vitin 2017 paditësi është suspenduar me pagese 50 % të pagës me arsyetimin se është ngritur aktakuzë për vepër penale të dënueshme me burgim, të cilën e ka precizuar me datën 22.01.2024.

Ne seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 30.01.2024 i autorizuari i paditësit ka deklaruar se: *mbetem pranë deklarimeve nga seancat e kaluara ku ka theksuar se nga dt. 11.04.2017 deri me dt. 30.04.2020 paditësi ka qenë i suspenduar me pagesë në lartësi prej 50 % të pagës që është dashur të realizoj për atë periudhë, gjithashtu paditësi nga dt. 05.05.2020 e këndej punon në një vend të punës që është më i ulët se sa vendi i punës që ka qenë i kthyer me vendim të inspektoratit të punës. Paditësi është i dëmtuar me 50 % te pagës, dhe shton se e kam pranuar parashtrësën-deklarimin i dt. 26.01.2024 nga e paditura Komuna e Glllogocit, e kundërshtoj të njëjtën pasi që nuk ka asgjë të re dhe fakt të ri lidhur me këtë çështje pasi që me datën 22.01.2024 kam dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësë për ndryshimin-zgjerimin dhe zmadhimin e kërkesëpadsisë si në parashtrësën e datës së lartëcekur, i propozoj gjykatës që në këtë seancë të lejoj ndryshimin-zgjerimin dhe zmadhimin e kërkesëpadsisë për lëndën C. nr. 593/20, ashtu që unë mbetem në tërësi pranë propozimit dhe precizimit të kërkesëpadsisë të datës së sipër cituar, dhe i propozoj gjykatës që të shkohet në procedurën e provave dhe fjalën përfundimtare. **Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar:** nga ky proces gjyqësor rezulton se baza e padsisë dhe e kërkesëpadsisë është vërtetuar mjaftueshëm, ashtu që i propozoj gjykatës që të miratoj kërkesëpadinë të bazuar që të detyroj të paditurën që për periudhën prej dt. 11.04.2017 deri me dt. 30.04.2020 të i kompensoj paditësit shumën siç vijon: për diferencën në pagë për kohen e suspendimit shumën prej 11.285,09 Euro, për kontributin pensional shumën prej 1.225,66 Euro, për tatimin në pagë shumën prej 456,10 Euro, ndërsa për periudhën prej datës 01.05.2020 deri me datën 30.11.2023 për diferencën nga vendi i punës profesor në SHFM në vendin e punës arsimtar i SHFMU në shumën prej 5.598,88 Euro, për kontributin pensional për këtë periudhë shumën prej 600,26 Euro, për tatimin në pagë shumën prej 102,55 Euro, krejt në shumën e përgjithshme për të dy periudhat në shumën prej **19.168,54 Euro**, të gjitha këto me kamatë në shkallën prej 8% nga dt. 11.04.2017 e deri në pagesën e plotë. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 2.276 Euro dhe atë sipas precizimit të dt. 22.01.2024 duke i shtuar edhe seancën e dt. 30.01.2024 në shumën prej 270 Euro, në këtë shumë përfshihet kompensimi për parashtrësën për precizim të kërkesëpadsisë të dt. 22.01.2024.*

I padituri nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.30.01.2024 dhe nuk ka marr pjesë në seancat e mbajtura në këtë proces gjyqësor, por në përgjigje në padi dhe në deklaratimet me shkrim të paraqitura në seancat e caktuara e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar pasi që është kontestuese pjesa e kërkesëpadsisë e cila i referohet çështjes për pagesën e 50% të pagave të pa paguara me rastin e suspendimit të tij si rezultat i ngritjes së aktakuzës në emër të tij për të cilën tashmë veç se është shpallur fajtor, sepse një kërkesë e tillë nga ana e tyre konsiderohet e pa bazuar pasi që me rastin e suspendimit të njëjtit kanë vepruar në bazë të legjislacionit në fuqi dhe atë të dispozitave të ligjit të punës si dhe ligjit për zyrtarët publik-personelin arsimor saktësisht Nenit 73 të këtij ligji, ndërsa në parashtrësën e dt. 26.01.2024 të paraqitur në gjykatë ka paraqitur **fjalën përfundimtare** ku kanë theksuar se: *mbështet deklaratimet e bëra gjatë kësaj procedurë gjyqësore duke e kundërshtuar në tërësi nga të gjitha bazat*

si të pa bazuar, pasi që nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura ashtu siç nuk janë kontestuese as deklaratimet e të paditësit të paraqitura në padi sa i për këtë vendimeve të inspektoratit të punës, pastaj vendimit përfundimtar në procedurën përmbartimore sa i përket kthimit në vendin e punës, i njëjti duke u bazuar në ligjin e punës, vendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega në Gllogoc PPP. nr... i dt. 28.02.2020 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda me nr. PKR. nr... i dt.14.11.2018 rikthehet në vendin e tij të punës si mësimdhënës në SHFMU "H..." dhe në SHFMU "A...". Ky sistemim është i aprovuar edhe nga ana e palës paditëse bazuar në Kontratën e punës të dt. 05.05.2020 me nr... Por kontestuese për palën e paditur mbetet pjesa e kërkesëpadiës sa i përket çështjes së pagesës së 50 % të pagave të pa paguara me rastin e suspendimit të paditësit si rezultat i ngritjes së aktakuzës në emër të tij për të cilën tashmë veç se është shpallur fajtor. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjendja faktike dhe Provat e administruara

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: *Kontrata e punës në mes të paditurës dhe paditësit e dt...; Vendim i inspektoratit të punës i dt... me nr...; Vendim i inspektoratit të punës i dt... me nr. të protokollit...; Aktvendim Gj.Th.P - Dega në Gllogoc PPP. nr... i dt...; Kërkesë e paditësit drejtuar të paditurit i dt...; Aktgjykim PKR. nr... i Gj.Th. Ferizaj i dt...; Vendimi i të paditurit për rikthim në marrëdhënie të punës të paditësit me nr... i dt...; Ekspertiza financiare e ekspertit R.S i dt...; Parashtrësë e të paditurit e dt. 20.shtator 2023; Kontrata e punës në mes të paditurës dhe paditësit e dt. 15.05.2020 me nr...; Aktvendimi për ndërprerjen të procedurës i dt. 11.12.2022; Parashtrësë-deklarim i të paditurit e dt. 07.12.2023; Parashtrësë për zgjerim dhe precizim të kërkesëpadiës e dt. 11.12.2023; Parashtrësë-deklarim i të paditurës e dt. 18.12.2023; Ekspertiza plotësuese financiare e dt. 27.12.2023 e ekspertit R.S; Parashtrësë-deklarim i të paditurës e dt.19.01.2024; Parashtrësë-deklarim i të paditurës e dt. 26.01.2024; Parashtrësë për ndryshim dhe zgjerim të kërkesëpadiës e dt. 22.01.2024; Procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor, së bashku me dëgjimin-deklaratën e ekspertit financiar R.S; Procesverbali i seancës përgatitore e dt. 20.07.2022; Procesverbali i seancës përgatitore e dt. 05.10.2022; Procesverbali i seancës përgatitore e dt. 09.11.2022, dhe Procesverbalet tjera në shkresat e lëndës.*

Gjykata pasi bëri vlerësimin e provave mbështetur në dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar pjesërisht, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mënyrë që të vërtetohet në mënyrë të saktë gjendja faktike, sipas propozimit të paditësit ka caktuar ekspertizë financiare për llogaritjen e diferencës së pagave të papaguara për shkak të suspendimit për periudhën kohore prill 2017 deri me prill 2020, si dhe për periudhën maj 2020 deri në nëntor 2023 për llogaritjen e diferencës së pagës së papaguar për shkak të uljes së gradës, shumës së trustit pensional dhe të tatimit në pagë.

Për të vërtetuar lartësinë e pagave të papaguara, pra diferencës së pagave, për paditësin gjykata në cilësinë e provës ka nxjerr ekspertizën financiare nga eksperti R.S të datës 24.08.2022 dhe Ekspertizën plotësuese financiare të tij të datës 27.12.2023. Detyrat e ekspertit janë përcaktuar mbi bazë të vëllimit që ka kërkuar pala paditëse për nxjerrjen e ekspertizës, në të cilat është kërkuar përlllogaritja e diferencës së pagës neto mes pagës së paguar sipas Kontratës së fundit dhe asaj të paguar (50% + 50%) para rikthimit në punë dhe pas rikthimit në punë për periudhën prej prill 2017 gjer prill 2020 dhe për periudhën prej maj 2020 gjer në pagën e procesuar të muajit nëntor 2023 për shkak të ndryshimit të kontratës së paditësit nga një vend i punës më i ulët se sa vendi i punës që ka qenë i kthyer me vendim të inspektoratit të punës.

Eksperti Financiar R.S me Ekspertizën e tij të datës 24.08.2022 ka konstatuar se: *fitimi i munguar nga mospagesa e 50% të pagës në periudhën e suspendimit përkatësisht për periudhën prill 2017 gjer tetor 2017 është: për çdo muaj për gjashtë muaj gjer tetor 2017 ajo shumë është: nga 303,13 Euro në muaj, shuma e kontributit pensional është shuma prej nga 16,59 Euro në muaj, dhe shuma për tatim në pagë është shuma prej nga 12.01 euro në muaj.*

Ndërsa në ekspertizën plotësuese financiare të tij të datës 27.12.2023 ka dhënë mendimin plotësues dhe ekspertimin e tij profesional se: *lartësia e mos pagesës së 50% të pagave të papaguara, kontributet pensionale dhe tatimi në burim, për periudhën e lartëcekur të suspendimit dhe pas suspendimit janë dhe atë si në vijim: për periudhën kohore prill 2017 deri me prill 2020 Paga Neto 50 % e pa paguar janë shuma prej 11,185.09 Euro, për Kontribute pensionale të pa paguara shuma prej 1,225.66 Euro, për Tatim në paga të papaguara shuma prej 456.10 Euro. Ndërsa për periudhën kohore prej muajit maj 2020 deri në muajin nëntor 2023 janë: Paga neto 50% e pa paguar për shkak të ndryshimit të kontratës është në shumën prej 5,598.88 euro, për kontributet pensionale të pa paguara është shuma prej 600.26 Euro, për tatim në paga të pa paguar është shuma prej 102.55 Euro, gjithsejt: Fitim i munguar në emër të pagave neto të papaguara është shuma prej 16,783.97 Euro, në emër të kontributeve pensionale është shuma prej 1,825.92 Euro, në emër të tatimit në paga është shuma prej 558.65 Euro, në shumën e përgjithshme prej 19.168,54 Euro për tërë periudhën e lartëcekur kohore.*

Gjykata ekspertizën financiare e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë dhe të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme, andaj dhe ia fali besimin.

Gjykata e vlerëson si të rëndësishme që ta ritheksoj për palët në këtë çështje, se gjatë procedimit në një çështje juridike-kontestimore, bazuar në dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore në fuqi, e njëjta vendos brenda kufijve të kërkesave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse.

Palët e kanë për detyrë që të paraqesin faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e tyre dhe ti propozojnë provat me të cilat konstatohet faktet e tilla, pra secila nga palët ka për detyrë që të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta.

Faktet jo kontestuese

Nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ka qenë i punësuar tek i padituri si mësimdhënës i lëndës..., me pagë mujore neto prej 442 €, ky fakt vërtetohet në bazë të Kontratës së Marrëdhënies së Punës me nr... e datës 16.11.2015 e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse nga data 01.09.2015 deri me datën 31.08.2018 pranë shkollës së mesme të lartë Gjimnazi GJ.K. S...

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi është suspenduar nga puna pas ngritjes së aktakuzës ndaj paditësit i cili ka qenë i suspenduar nga dt. 11.04.2017.

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës me nr... i dt... është aprovuar ankesa e tij për kthimin në vendin e punës.

Nuk ishte kontestues fakti se i padituri e ka atakuar vendimin e Inspektoratit të Punës... i dt... e cila ankesë është refuzuar me Vendimin e dt... me nr. të protokollit... dhe ka lënë në fuqi Vendimin 01 Nr... i dt...

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi është dënuar për veprat penale me të cilat është ngarkuar me aktakuzë dhe është dënuar me dënim të kushtëzuar në bazë të Aktgjykimit PKR. nr... i datës...

Nuk ishte kontestues fakti se Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Gllogoc në bazë të Aktvendimit PPP. nr... ka refuzuar prapësimin e të paditurit me të cilin është lejuar propozimi për përmbarrim i paditësit për kthim në vendin e punës.

Nuk ishte kontestues fakti se i padituri ka Rikthyer në punë paditësin si Mësimdhënës në SHFMU “H...” në... me 10 orë mësimi dhe në SHFMU “A...” në... me 10 orë mësim në bazë të Vendimit Nr... i dt...

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka lidhur me të paditurin Kontratë të Punës me datën 05.05.2020 me nr... si mësimdhënës në Shkollën Fillore të mesme të ulët SHFMU “ H...” në... me 10 orë mësimi, dhe në Shkollën Fillore të mesme të ulët SHFMU “A...” në... me 10 orë mësim.

Faktet Kontestuese

Si kontestues në mes palëve ndërgjyqëse ishte fakti se a i takon kompensimi paditësit si në kërkesëpadi për periudhën prill 2017 gjer 30 prill 2020 dhe prej 01 maj 2020 gjer 30.09.2023.

Kontestues mes palëve ndërgjyqësve ishte edhe fakti i pagesës së 50 % të pagave të pa paguara me rastin e suspendimit nga puna të paditësit si rezultat i ngritjes së aktakuzës në emër të tij për të cilën është shpallur edhe fajtor.

E paditura e konteston kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se mungon baza ligjore duke pasur parasysh e njëjta i ka përmbushur të gjitha obligimet financiare ndaj paditëses për periudhën kontestuese dhe atë konform Nenit 74 të Ligjit të Punës.

Ligji material i zbatuar

Gjykata vlerësoj se vendosja e kësaj çështje juridike kontestuese si në dispozitiv të aktgjykimit sa i përket aprovimit të pjesërisht të padisë së paditësit gjen mbështetje ligjore në dispozita e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), dhe në dispozitat të Ligjit të Punës në fuqi gjer me datën 10.09.2019, dhe Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 të datës 11.03.2019 të hyrë në fuqi me datën 11.09.2019 në fuqi gjer me datën 24.09.2023.

Me Nenin 17 par. 1 të Ligjit të Punës parashihet “*I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune*”. Me Nenin 73 par. 1 të Ligjit të Punës parashihet “*I punësuari mund të largohet përkohësisht nga puna, kur: 1.1. ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale; 1.2. i punësuari është në vuajtje të paraburgimit; 1.3. kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj. Kurse me Neni 74 parashihet se “*Kompensimi i pagës gjatë largimit të përkohshëm gjatë kohës së largimit të përkohshëm nga puna, sipas nenit 73 të këtij ligji, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit në pagë në lartësi prej 50%*”. Kurse me Nenin 75 parashihet se “*Largimi i përkohshëm nga puna sipas Nenit 73 të këtij ligji, mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj, periudhë në të cilën punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t’ia shkëpusë Kontratën e Punës*”. Me dispozitën e Nenit 79 është paraparë e drejta e punëmarrësit për të kërkuar mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës përmes inicimit të rastit në gjykatën kompetente dhe atë duke e përcaktuar si në vijim “*Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga Neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente*”.*

Neni 74 par. 1, par. 2, par. 3 dhe par. 5 i Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 përcakton se “*1. Zyrтари i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. 2. Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit. 5. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente*”.

Neni 52 par. 1 i Ligjit për zyrtarët Publik nr. 06/L-114 përcakton se “Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori në këto raste. 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.2. për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 vjetëve; 1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës”. Neni 54 par. 1 përcakton se “Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori”. Neni 53 par. 1 i Ligjit për zyrtarët Publik nr. 06/L-114 përcakton se “1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; 1.2. e shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj; 1.3. të përfundimit të pezullimit me kërkesë të nëpunësit civil kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës”.

Nenin 8 par. 1 dhe par. 2 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) përcakton se 1. “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit. 2. Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit”.

Neni 136 i LMD-së përcakton se “kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Neni 137 i LMD-së përcakton në par. 1 se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm), dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur)...”, në par. 3 përcakton se “Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmer veprimin”. Neni 169 par. 1 i LMD-së përcakton se “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”. Neni 174 i LMD-së përcakton se “Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”.

Neni 245 par.1 i LMD-së përcakton se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, me të cilin konstatohet se ekziston e drejta e palës paditëse që në cilësinë e kreditorit të kërkojë nga pala e paditur, kompensimin e detyrimeve të kontraktuara në marrëdhënien e punës, detyrim ky, si rrjedhojë e veprimeve të kundërligjshme të paditurit për mos pagesë të diferencës së pagave të papaguara për shkak të suspendimit dhe diferencës së pagës së papaguar për shkak të uljes së gradës e që kanë konsistuar në shkeljen e dispozitave të Kontratës së Punës respektivisht dispozitave të Ligjit të Punës dhe të Ligjit për Zyrtarët Publik. Ndërsa bazuar në dispozitën e Neni 249 par. 1 i LMD-së që ka përcaktuar se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t'i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t'i kishte të njohura”.

Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Gjatë kësaj procedure gjyqësore, është provuar se i padituri e kishte suspenduar paditësin nga puna me datën 11.04.2017 për shkak se paditësit ishte ngritur Aktakuza për veprat penale “Ushtrimi i Ndikimit” nga Neni 431 par.1 të KRPK-së, për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve zyrtare” nga Neni 434 par. 1 të KPRK-së, dhe për veprën penale “Dhënie Ryshfeti” nga Neni 429 par. 1 të KPRK-së. Mbi bazën e kësaj i padituri ka marr vendim që të suspendoj nga puna paditësin me 50 % te pagës, duke u bazuar në Ligjin e Punës i aplikueshëm në kohën e suspendimit.

Pastaj, pasi që paditësi është shpallur fajtor për veprat penale të lartëcekura nga Gjykata Themelore në Ferizaj është dënuar me Aktgjykim PKR. nr... me datën... me dënim të kushtëzuar me dy vite

burgim i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej dy viteve nuk kryen vepra tjera penale, por ai aktgjykimi nuk ka paraparë tjera dënime plotësuese të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, andaj nuk kishte pengesa ligjore për ushtrimin e profesionit dhe të detyrës si mësimdhënës në shkollën e mesme të lartë.

Pas vendimit të dhënë nga Gjykata Themelore në Ferizaj, paditësi ka bërë ankesë në Inspektoratin e Punës që të ri-kthehet në vendin e tij të punës. Inspektorati e ka aprovuar ankesën e paditësit me Vendimin e datës... me nr... duke e obliguar të paditurën që të rikthej në punë paditësin. I padituri i pa kënaqur me Vendimin e Inspektoratit të Punës të datës... me nr... ka atakuar këtë vendim me ankesën në shkallën e dytë të Inspektoratit të punës, ku i njëjti organ ka nxjerr Vendim me datën... me të cilën ka refuzuar ankesën e të paditurit duke lënë në fuqi Vendimin e lartëcekur të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës të datës... me nr...

Në rastin konkret, pas procedurës përmbimore të kthimit në punë e paditura e ka kthyer në punë paditësin por jo me të gjitha të drejtat që i takojnë dhe jo në detyrën para suspendimit por ka zbatuar pasoja që nuk ishin paraparë as në Aktgjykimin penal të lartëcekur dhe që ishin në kundërshtim me kontratën e punës dhe me ligjin e lartëcekur për zyrtarët publik. Kjo ka rezultuar që e paditura të bëjë shkelje ligjore, e njëjta nuk ka vepruar në bazë të Kontratës së Punës dhe në bazë të dispozitave ligjore të lartëcekura të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Zyrtarët Publik nga të cilat burojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve përgjatë tërë periudhës kohore të lartëcekur dhe në vazhdim.

E paditura pas kalimit të afatit të suspendimit prej 6 muaj pas suspendimit ka pas obligim që paditësit të ia kthej të gjitha të drejtat ligjore dhe të kryej obligimin dhe atë të pagës në 100 % nga datën 11.10.2017 gjer 30.04.2020 si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi edhe përkundër se ka nxjerr Aktvendim për kthim në punë të paditësit me datën 05.05.2020 por me përmbajtje në kundërshtim me ligjin dhe përkundër vendimeve të lartëcekura të Inspektoratit të Punës. E paditura pas kthimit në punë të paditësit ka pas obligim që paditësit të ia njoh të gjitha të drejtat në të të njejtën kategori si mësimdhënës në shkollë të mesme të lartë.

Gjykata vlerëson se Kontrata e punës e vitit 2015 është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht dispozitat nga Neni 11 i po të njëjtit ligj ku parashihet përmbajtja e kontratës së punës, ndërsa pika 1.11 e cila përcakton se *“kontrata e punës duhet të përmbaj edhe lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjera”*, e në rastin konkret Neni 2 i kontratës së lidhur në mes palëve ka përcaktuar pagën bazë për punën të cilën e kryen. Ndërsa me kontratën e punës të datës... pas kthimit nga puna të njëjtit paditësit i është ndryshuar kategoria e punësimit në një kategori më të ulët, kjo sepse në kontratën e vitit 2015 ishte mësimdhënës në shkollë të mesme të lartë në... ndërsa me kontratën e punës të vitit 2020 ishte caktuar mësimdhënës në shkollë të mesme të ulët dhe jo në shkollë të mesme të lartë përkatësisht jo të barazvlefshme. Andaj, gjykata vlerëson se i padituri ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartëcekura të Nenit 52 par. 1, Nenit 53 par. 1 dhe Nenit 54 par. 1 të Ligjit për zyrtarët Publik nr. 06/L-114, dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitat kontraktuale të Kontratës së Punës të vitit 2015 e vazhduar, sepse rikthimi në vend të punës me ri-sistemim në një kategori më të ulët të punës nga shkolla e mesme e lartë në shkollë të mesme të ulët, me një pagë më të vogël si dhe edhe me ndalesë të pagës prej 50 % të pagës bazë për periudhën pas suspendimit gjer në lidhjen e kontratës në vitin 2020 si mësimdhënës, të gjitha këto janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të largimit nga puna nga Ligji i punës dhe janë edhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartëcekura të Ligjit për Zyrtarët Publik në lidhje me transferimin e përkohshëm apo të përhershëm apo të ristrukturimit sepse asnjëri kriter ligjor nga këto dispozita ligjore nuk është plotësuar që të veprohet në këtë mënyrë siç ka vepruar i padituri.

Andaj, obligimi për përmbushjen e kontratës nga ana e palës së paditur rrjedh duke u bazuar nga Kontrata e punës të lartëcekur të vitit 2015, dhe duke u bazuar edhe në Nenin 17 të Ligjit të Punës ku përcaktohet se *“pjesëmarrësit e marrëdhënieve të detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin*

e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen përcakton se “detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve në marrëdhëniet e detyrimit ose në bazë të ligjit”. Obligimi për përmbushjen e kontratës rrjedh duke u bazuar edhe në Nenin 8 par. 1 dhe par. 2 të LMD-së si më lartë që përcakton përmbajtje pothuajse të njëjtë me Nenin 17 të Ligjit të Punës si më lartë. Është parim në LMD i paraparë edhe në Nenin 4 se “Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë”. Se e paditura i obligohet paditëses si në pikën II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit këtë fakt gjykata e mbështet edhe në Nenet e lartëcekura-Neni 245 paragrafi 1 dhe Neni 249 të LMD.

Gjykata lidhur me lartësinë e vendosur si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në Ekspertizën financiare të datës 24.08.2023, dhe Plotësim Ekspertizën e datës 27.12.2023 të ekspertit gjyqësor financiar R.S të cilave gjykata ua fali besimin. Kjo pasi që e paditura fillimisht ka suspenduar paditësin nga puna me pagesë me 50 % të pagës në bazë të Ligjit të Punës-Neni 75 që përcakton se “*Largimi i përkohshëm nga puna sipas nenit 73 të këtij ligji, mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj, periudhë në të cilën punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t’ia shkëpusë Kontratën e Punës*”.

Rrjedhimisht, në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka vërtetuar se palës paditëse i është shkaktuar dëmi gjegjësisht fitimi i humbur që konsiston në pengimin e rritjes së pasurisë e cili do të ishte evident në të ardhmen, dhe që do ta realizonte i dëmtuari në këtë rast paditësi sikurse i padituri të mos i kishte shkelur dispozitat e Kontratës së Punës respektivisht dispozitat e Ligjit të Punës dhe dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik.

Në lidhje me vendimin në pjesën refuzuese si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në provat dhe dispozitat ligjore të lartëcekura dhe më poshtë, gjykata gjeti si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit vetëm sa i përket periudhës prej datës 11.04.2017 deri me datën 11.10.2017. Kjo, pasi që e paditura e ka suspenduar paditësin nga puna me 50 % të pagës për periudhën prej 6 muaj duke u bazuar në Nenin 73 par. 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “*I punësuarit mund të largohet përkohësisht nga puna*”, kurse pika 1.1 përcakton se “*ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale*”. Andaj gjykata e ka refuzuar shumën e cekur si në pikën IV të dispozitivit për shkak se një pasojë e tillë buron nga vet ligji-përkatësisht nga dispozita ligjore e Nenit 73 par. 1 që përcakton humbje të drejtës së të punësuarit-paditësit për pjesën tjetër prej 50 % të pagës për shkak të procedurës penale të iniciuar ndaj tij. Ndërsa sa i përket lartësisë së refuzimit të kërkesëpadisë si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimit gjykata e bazoj në shumat përkatëse nga Ekspertiza financiare gjyqësore e datës 24.08.2022 të përshkruara në pasusin 1 në faqe 4 të këtij aktgjykimi.

Gjykata i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi dhe në parashtrësën-deklarimin e të paditurit të datës 26.01.2024 drejtuar gjykatës, mirëpo të njëjtat nuk kishin relevancë në vendosjen ndryshe pos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ligjore ka vendosur në mbështetje të Nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, paguan edhe kamatën. Lartësia e kamatës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën V të dispozitivit është e bazuar në Nenin 452.1 të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës (Tarifa e OAK-së), ashtu që lartësia e shpenzimeve të aprovuara pjesërisht si në pikën V të dispozitivit i referohet: për padi shumën prej 208

Euro, për taksë gjyqësore në shumën prej 100 Euro, për ekspertizë financiare shumën prej 200 Euro, për plotësimin e ekspertizës financiare shumën prej 75 Euro, për tre seanca të mbajtura në shumën nga 208 Euro secila dhe për tre seanca të shtyera secila nga 135 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1798 €.

Ndërsa për pjesën e refuzuar të shpenzimeve si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi për parashtrësën për precizim të kërkesëpadisë me datën 22.01.2023, gjykata e refuzoj bazuar në nr. tarifor 6 të Tarifës së OAK-së ku njihen shpenzimet për parashtrësia me të cilat iniciohet procedura e nuk njihen shpenzimet edhe për parashtrësia për precizim të kërkesëpadisë.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC-
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil, C. nr. 593/2020, datë 23.02.2024**

**Gjyqtari
Astrit Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditë, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.